



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:024118

Datë: 24.01.2025

Numri i dokumentit: 06755788

KF.nr.958/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në konfliktin tregtar administrativ të paditësit “Ardi” Sh.P.K., me seli në Fushë Kosovë, dhe me numër unik identifikues 810517089, përfaqësuar nga Shoqëria e Avokatëve “SCRL Partners” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti rivlerësim malli, vlerë e kontestit 8,534.63€ në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur me datë 16.01.2025 në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse dhe në prani të përfaqësueses së palës së paditur B. G., mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit “Ardi” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810517089, me seli në Fushë Kosovë.
- II. ANULOHET aktvendimi me nr.01.3.2.2/15405 i datës 30.08.2022 i Doganës së Kosovës në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë, që paditësit “Ardi” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810517089 me seli në Fushë Kosovë, t’ia kthej shumën prej 8,534.63€ (tetë mijë e pesëqind e tridhjetë e katër euro e gjashtëdhjetë e tre cent) të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore (DUD) me nr.R-15017/16.07.2022, të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prishtina 3, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “Ardi” Sh.P.K., me seli në Fushë Kosovë, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 11.10.2022, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, për anulimin e vendimit nr.01.3.2.2/15404 të datës 30.08.2022 të Doganës së Kosovës, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të dispozitave materiale, shkeljeve të dispozitave procedurale dhe rritjes së paarsyeshme të çmimit të mallit. Gjykatës i ka propozuar të aprohet në tërësi si e bazuar padia e paditësit, të anulohet si i pabazuar në tërësi aktvendimi kontestues i të paditurës nr.01.3.2.2/15404 datë 30.08.2022, sipas të cilit aktvendim është refuzuar si e pabazuar kërkesa e paditësit për rishqyrtimin e vendimit kontestues, dhe të obligohet e paditura Dogana e Kosovës që mjetet monetare më shumë të paguara në emër të detyrimeve doganore, t’i kthehen paditësit në xhironlogari bankare në shumë prej 8,534.63€. Tutje paditësi në padi ka deklaruar se me rastin e paraqitjes së mallit doganor për zhdoganim, deklaratës Doganore i janë bashkangjitur të gjitha dokumentet përcjellëse të mallit të cilat kërkohen si dokumente që duhet t’i bashkëngjiten deklaratës doganore për vendosje të mallit në qarkullim të lirë në përputhje me nenin 123 të UA 11/2009 mbi Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave. Të gjitha këto dokumente janë të harmonizuara në kuptim të vlerës së transaksionit të kryer për mallin e blerë. Më tej ka shtuar se e paditura nuk i ka analizuar dokumentet e bashkangjitura deklaratës doganore, sepse nga këto dokumente mund të konstatohet lehtësisht se malli doganor është blerë sipas vlerës së faturës, të cilën rrethanë e vërtetojnë dokumentet përcjellëse të mallit, fatura, kontrata me dërguesin e mallit. Por pavarësisht dokumenteve të pakontestueshme e paditura ka kontestuar vlerën e mallit dhe në këtë mënyrë ka rivlerësuar mallin sipas metodës së gjashtë të vlerësimit. Tutje ka deklaruar se paditësi ka paraqitur faturën e blerës të mallit si dhe urdhëresën bankare dhe bazuar në nenin 33 të KDA-së vlera e mallit është vlera e transaksionit të paguar apo të pagueshëm dhe bazuar pikërisht në këtë nen të KDA-së dhe duke pasur parasysh faktin se paditësi ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore për aplikimin e këtij neni, e paditura do të duhej të pranonte vlerën e deklaruar të mallit përkatësisht vlerën e transaksionit të mallit duke përdorur në këtë mënyrë metodën e parë të vlerësimit të mallit e jo metodën e gjashtë të vlerësimit.

Përfaqësuesja e autorizuar e paditësit, përmes emailit të dërguar më 15.01.2025, i është drejtuar zyrtares ligjore Arta Hyseni duke kërkuar që seanca e planifikuar për datën 16.01.2025 në orën

11:00 të shtyhet për pasdite, konkretisht pas orës 13:00. Arsyeja e paraqitur ka qenë fakti se në orën 10:00 dhe 11:00 të po asaj date janë caktuar të mbahen dy seanca të tjera të gjyqtarit Fisnik Nuli, në të cilat janë ftuar të marrin pjesë edhe ekspertë. Në email, përfaqësuesja ka theksuar se edhe përfaqësuesit e Doganës janë njoftuar përmes emailit dhe ka shprehur bindjen se kjo nuk do të përbënte problem për ta. Zyra e gjyqtarës, përmes emailit, i është përgjigjur kërkesës së përfaqësueses së paditësit duke e njoftuar se seanca nuk do të shtyhet dhe do të mbahet në datën dhe orën e caktuar. Më 16.01.2025, parashtresa është dorëzuar fizikisht në zyrën e gjyqtarës nga Zyra e Menaxhimit të Lëndëve (ZML) në orën 09:50.

E paditura në përgjigje në padi të datës 12.12.2024 e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Më tej ka shtuar se vendimi i atakuar është marr konform dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marr me shkelje ligjore nuk qëndron, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marr konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme duke i propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoi si të pa bazuar dhe ta lë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm. Gjatës seancës së shqyrtimit kryesor përfaqësuesja e palës së paditur ka deklaruar se e kundërshtojnë padinë dhe kërkesëpadinë e palës paditëse si të pabazuar. Mbesin në tërësi pranë përgjigjes në padi si dhe sqarimeve dhe elaborimeve si në arsyetimin e vendimit të nxjerrë nga dogana. Pasi që paditësi në procedurën e administrimit të provave dokumentacioni përcjellës i mallit është vlerësuar si provë e pamjaftueshme për arsye se në procedurën administrative të zhvilluar pranë të paditurës paditësi nuk ka arritur të dëshmojë vlerën e transaksionit me dokumentacion të harmonizuar pasi që në shkresat e lëndës nuk ka prezantuar kontratën e shitblerjes, deklaratën eksportuese ashtu siç është elaboruar në aktvendimin e atakuar me padi andaj dogana mbi bazën e dispozitave ligjore të KDA ka vendosur konform nenit 35 pra sipas të dhënave të disponueshme dhe duke u bazuar në UA nr.06/2015 për shpenzime të transportit sipas vendimit të qeverisë 17/36 i ka përfshirë shpenzimet e transportit detar. Lidhur me vlerën e kontestit ka theksuar se nuk mund të deklarohen meqenëse nuk kanë të dhëna në shkresat e lëndës. Gjykatës i ka propozuar që të marr aktgjykim me të cilin refuzohet në tërësi si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit dhe të lë në fuqi aktvendimin kontestues si të drejtë dhe të ligjshëm.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik të datës 16.01.2024 ka administruar provat si në vijim: Aktvendim 01.3.2.2/15404 të datës 30.08.2022, DUD R 15017 datë 16.07.2022 (me MV1 dhe MV6), Faturë

nr. CJ22012, Packing list, CMR, Transfer bankar i datës 13.07.2022, Ankesë në doganë datë 21.07.2022, Proces mbi përcaktimin e vlerës së mallrave.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjet në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, vlerësoi secilën provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, dhe duke u mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Në këtë procedurë gjyqësore të kontestit tregtar administrativ në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se subjekti “Ardi” ShPK, përmes Deklaratës unike doganore R15017/16.07.2022 të ZBD Prishtina 3 ka deklaruar për zhdoganim mallin lëndor, sipas dokumentacionit përcjellës të mallit. Po ashtu, nuk ishte kontestuese as fakti tjetër që paditura e rivlerësuar DUD-in e deklaruar nga metoda e parë në metodën e gjashtë. Padiësi i pakënaqur me rivlerësimin e lartcekur ka ushtuar kërkesë për rishyqrtimin e vendimit të ZBD Prishtina 3 e për të cilën kërkesë e paditura e ka refuzuar duke lënë në fuqi vendimin/DUD R15017. Ndaj këtij aktvendimi padiësi me padinë e datës 11.10.2022 ka iniciuar këtë konflikt tregtar administrativ. Kontestuese në mes të palëve mbetet harmonizmi i dokumentacionit me qëllim të vërtetimit se vërtet padiësi ka paguar vlerën reale të mallit lëndor.

Nga arsyetimi i vendimit kontestues gjykata konstaton se e paditura ka refuzuar ankesën e padiësit me arsyetimin se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur gjatë vlerësimit të mallit është bazuar më metodën e gjashtë të vlerësimit neni 35, i Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të të dhënave të disponueshme të dosjes së vlerës dhe zhdoganimeve të mallrave të ngjashëm që në rastin konkret janë marr si të dhëna të disponueshme për të përcaktuar vlerën e mallit lëndor kontestues. Po ashtu thekson se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur subjektit në procedurë i është kontestuar pariteti dhe i janë involvuar shpenzimet e transportit për importin kontestues sipas Udhëzimit Administrativ (QRK) nr.06/2015 për përcaktimin e kostove të shpenzimeve të transportit të mallrave të importuara të ndryshuar dhe plotësuar me vendimin e Qeverisë 17/36 të datës 22.09.2021, i cili vendim ka ndryshuar/plotësuar vlerën e shpenzimeve të transportit detar dhe kontejnerëve në shtojcën 2 të UA 06/2015 për përcaktimin e kostos së shpenzimeve të transportit të mallrave të importuara konform listës së çmimeve të përditësuara si pjesë përbërëse e këtij vendimi, kjo ka rezultuar pas hulumtimeve të bëra nga Sektori i Vlerës së Doganës së Kosovës dhe krahasimit të

çmimeve, në veçanti për periudhën 2020/21, është evidentuar një ngritje e theksuar e kostos së shpenzimeve të transportit, kryesisht Azia e determinuar nga faktor të ndryshëm ekonomik.

Me Dispozitën ligjore të nenit 33 par 1 të KDAK-së është përcaktuar se *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37”*.

Tutje, në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së përcaktohet se *“Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjeti tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë”*.

Ndërsa, se cilat dokumente duhet t'i bashkëngjiten deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit, është e rregulluar me nenin 123 par. 1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, ku decidivisht përcaktohet se *“a) fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*.

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykatës i rezultoi një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ. Gjykata konstaton se dokumentacioni për mallin lëndor i paraqitur në procedurën administrative dhe në këtë konflikt administrativ është i mjaftueshëm për të konstatuar se vërtet paditësi ka paguar vlerën reale të mallit lëndor.

Deri te ky konstatim gjykata erdhi pas analizimit faturës nr.CJ22012 të datës 08.06.2022 me vlerë prej 36,500.00€, urdhërpagesës bankare ndërkombëtare të datës 13.07.2022 në vlerë prej 36,500.00€ me përshkrimin *“Payment for invoice with no:CJ22012”*, të cilat janë në përputhje të plotë me vlerën e DUD-it kontestues R-15017/16.07.2021.

Po ashtu Gjykata konstaton se aplikimi i metodës së 6 të vlerësimit në vështrim të nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, është veprim i cili bie ndesh me dispozitat e nenit 33-35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L109, për arsye, se para se të aplikohet metoda e fundit e vlerësimit gjegjësisht metoda e 6 e vlerësimit, duhet të jepen arsyet dhe provat për ta kontestuar vlerën e mallit lëndor.

Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit pariteti dhe janë involvuar shpenzimet të transportit sipas udhëzimit administrativ 06/2015 dhe vendimit të Qeverisë 17/36 të datës 22.09.2021. Gjykata konsideron se e paditura do të mund ta mbështeste një konstatim të këtillë vetëm atëherë kur do të mund të siguronte dëshmi konkrete se paditësi për mallin lëndor kontestues, i ka paguar eksportuesit vetëm çmimin neto të faturës të mallit pa përfshirë edhe shpenzimet e transportit detar deri në Kinë, ku vlera e mallit të faturuar me faturën nr. CJ22012, nga eksportuesi është paguar nga paditësi përmes Urdhërpagesave Ndërkombëtare me status të aprovuar të datës: 13.07.2022, në emër të mallit me paritet CIF dhe e cila pagesë është në harmoni të plotë në kuptim të shumës dhe përfituesit si në faturë. Gjykata vlerëson se nuk përbën shkak ligjor për kontestim të shpenzimeve të transportit dhe caktim të bazës së re doganore duke ndryshuar edhe paritetin e mallit për paditësin, fakti që e paditura duke iu referuar vendimit të Qeverisë nr.17/36 dhe Shtojcës 2 të UA nr.06/2016 për përcaktimin e kostos së shpenzimeve të transportit të mallrave, për arsye se me dispozitën ligjore të nenit 31 par.1 të KDAK- 5 shprehimisht përcaktohet se “Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37”. Ndërsa në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së është parashikuar që “Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjeti tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë”.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore dhe prova materiale të besueshme e ka rivlerësuar mallin lëndor të deklaruar për zhdoganim nga paditësi, përmes DUD-it, R-15017/16.07.2022, të proceduar në ZBD Prishtina 3, dhe në këtë mënyrë të njëjtin e ka

obliguar pa të drejtë me pagesën e detyrimeve shtesë importuese doganore në shumë prej 8,534.63€, mbi vlerën e deklaruar të mallit të importuar.

Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi, nuk është vlera reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së.

Arsyetimi i të paditurës i dhënë në vendimi e kontestuar se në shkresat e lëndës mungon deklarata eksportuese e shtetit eksportues dhe mungon kontrata e shitblerjes, për gjykatën nuk është i bazuar, sepse me dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109 dhe as me dispozitat e UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave, nuk parashihet që deklarata eksportuese dhe kontrata e shitblerjes është dokument i cili duhet bashkangjitur deklaratës doganore, për vendosje në qarkullim të lirë të mallit të importuar dhe për tu aplikuar metoda e parë e vlerësimit sipas nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Gjykata konstaton se në rastin konkret paditësi ka vërtetuar se pagesa e faturës nr.CJ22012 të datës 008.06.2022 e deklaruar me DUD-in R-15017/16.07.2022 është realizuar përmes transferit ndërkombëtar të datës 13.07.2022 me status ekzekutuar në vlerë prej 36,500.00€, në të cila pagesa është shënuar numri i faturës.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se të gjitha dokumente e prezantuar të paditurës lidhur me deklaratën unike doganore kontestuese, rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi konform nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Prandaj nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë, Gjykata pretendimet e paditësit lidhur me deklaratën unike doganore kontestuese, i vlerësoi si tërësisht të bazuar dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor, konform nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave.

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 46 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ashtu që aprovoi kërkesëpadinë e paditësit, e anuloi vendimin e kontestuar të të paditurës dhe e detyroj të

paditurën që paditësit t'i kthej shumën prej 8,534.63€ të paguar më tepër për shkak të rivlerësimit jo të drejtë të mallit, në emër të detyrimeve importuese.

Vlerën e detyrimeve doganore Gjykata e ka përcaktuar duke u bazuar në DUD-in para rivlerësimit dhe atë të rivlerësuar. Sipas të dhënave, në DUD-in e rivlerësuar, vlera e taksave doganore është 19,553.13€, ndërsa në DUD-in para rivlerësimit kjo vlerë është 11,018.50€. Si rezultat, diferenca ndërmjet këtyre dy vlerave është 8,534.63€, e cila paraqet ndryshimin midis vlerës së rivlerësuar dhe asaj fillestare.

Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga të lartcekurat, gjykata konform nenit 46 par. 2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.958/22, datë 16.01.2025

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.